



HISTORIA E PARLAMENTARIZMIT NË MAQEDONI

Kushtetuta e Republikës së pavarur dhe sovrane së Maqedonisë është miratuar më 17 nëntor 1991. Sipas Kushtetutës Maqedonia është shtet me demokraci parlamentare, ndërsa pushteti shtetëror është i ndarë në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës. Kuvendi është njëdhomësh dhe e përbëjnë nga 120 deri në 140 deputetë. Deputetët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta me votim të fshehur, ndërsa mandati i tyre është i lirë dhe zgjat 4 vjet.

Themelet historike të Kuvendit janë vendosur me Republikën e Krushevës nga viti 1903 dhe në KAÇKM-në nga viti 1944, duke u ndërlidhur me Kuvendin Popullor të RPM-së nga viti 1946 dhe Kuvendin e RSM-së nga viti 1963 dhe 1974.

Në pasqyrën e dhënë më poshtë janë paraqitur ngjarjet më të rëndësishme historike dhe datat, të cilat e karakterizojnë zhvillimin bashkëkohor të parlamentarizmit Maqedonas.

2 GUSHT 1903

Në këtë datë u ngrit Kryengritja e lindenit për çlirimin e popullit maqedonas nga pushteti turk. Më 3 gusht, pas çlirimit të Krushevës, ka filluar konstituimi i pushtetit të ri revolucionar-demokratik popullor, që në historiografi njihet si Republika e Krushevës, që ka zgjatur 10 ditë. Për zgjedhje më demokratike të organeve të pushtetit është konvokuar Kuvendi i përbërë nga 60 qytetarë më të shquar, përfaqësues të të gjitha kombeve në qytetin e Krushevës (maqedonas, shqiptarë dhe vllah) si organ përfaqësues parlamentar.

Kuvendi e ka zgjedhur Qeverinë e përkohshme ekzekutive gjashtë anëtarëshe. Idetë e avancuara demokratike të revolucionarëve, dëshirat për bashkëjetesë, barazia midis kombësive për pajtim vëllazëror dhe unitet kundër despotizmit turk (osman) janë pasqyruar në Manifestin e Republikës së Krushevës. Manifesti i Republikës së Krushevës është një ndër dokumentet më të rëndësishme në historinë e Lëvizjes Nacionale Çlirimtare. Edhe pse Republika e Krushevës ka ekzistuar vetëm dhjetë ditë, ajo zë vend të posaçëm në historinë tonë, për shkak se është simbol i aspiratave shtetëformuese të popullit maqedonas dhe themel i shtetësisë maqedonase.

2 GUSHT 1944

Në manastirin e Shën. Prohor Pçinskrit është mbajtur Mbledhja e Parë e KAÇKM-së (Kuvendi Antifashist Nacional për Çlirim të Maqedonisë).

Me pjesëmarrjen e popullit maqedonas në Luftën e Dytë Botërore dhe në Luftën Nacionale Çlirimtare kundër fashizmit, populli maqedonas e fitoi lirinë nacionale dhe krijoi shtetin e vet, konstituimi i të cilit është kurorëzuar me Mbledhjen e parë të KAÇKM-së.

Në Mbledhjen e parë të KAÇKM-së janë miratuar nëntë akte ligjvënëse, nga të cilat katër kanë karakter konstituiv shtetëror. Me këto akte janë vendosur themelet e shtetit tonë, si shtet federal në përbërje të Jugosllavisë Demokratike Federative. Në këtë mbledhje solemnisht shpallet konstituimi i Maqedonisë Demokratike Federative.

KAÇKM-ja konstituohet në organ suprem ligjvënës, organ përfaqësues ekzekutiv i popullit dhe organ suprem i Maqedonisë Demokratike Federative. Gjithashtu është formuar Presidiumi i KAÇKM-së si bartës i kompetencave ekzekutive dhe ligjvënëse, të cilat i kryen gjatë mbledhjeve plenare të KAÇKM-së.

Në këtë mbledhje është miratuar Deklarata për të drejtat themelore të qytetarëve, sipas së cilës "të gjithë qytetarët e shtetit federal maqedonas janë të barabartë para ligjeve, pa marrë parasysh kombësinë, racën dhe besimin e tyre".

Gjuha popullore maqedonase bëhet gjuhë zyrtare e shtetit, ndërsa data 2 gusht shpallet festë popullore dhe shtetërore e popullit dhe shtetit maqedonas, si simbol i të gjitha betejave për çlirim nga robëria shekullore dhe për krijim të shtetit të lirë dhe të pavarur.

Për nder të dy ngjarjeve të mëdha, të cilat kanë ndodhur në këtë ditë, në linden, ku janë vendosur themelet e shtetësisë dhe pavarësisë maqedonase, 2 gushti është shpallur si festë shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Dita e Republikës.



Presidiumi i KAÇKM-së në krye me Metodija Andonov Çento

14-16 PRILL VITI 1945

Në mbledhjen e tretë KAÇKM-ja është emërtuar Kuvendi Popullor i Maqedonisë Demokratike Federative. Akti më i rëndësishëm shtetëror-juridik i miratuar në këtë mbledhje është formimi i qeverisë së parë, si organ ekzekutiv i shtetit maqedonas (nga marsi i vitit 1946 është riemërtuar Republika Popullore e Maqedonisë). Me këtë është përmbyllur procesi i konstituimit të pushtetit popullor, si dhe afirmimi i pavarësisë shtetërore dhe nacionale të popullit maqedonas.

31 DHJETOR VITI 1946

Kuvendi Kushtetues i Republikës Popullore të Maqedonisë i zgjedhur në zgjedhje të lira, me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, e miratoi Kushtetutën e parë të Republikës Popullore të Maqedonisë. Kjo Kushtetutë ka rëndësi të madhe historike dhe politike për popullin maqedonas. Republika Popullore e Maqedonisë është përkufizuar si shtet popullor me formë republikane të udhëheqjes, e bashkuar me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe republikat e tyre popullore: Republikën Popullore të Serbisë, Republikën Popullore të Malit të Zi, Republikën Popullore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikën Popullore të Kroacisë dhe Republikën Popullore të Sllovenisë, brenda një shteti të përbashkët federal - Republika Federative Popullore e Jugosllavisë (në vitin 1963 u riemërtua në Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë). Sipas Kushtetutës, parimi kryesor i organizimit të pushtetit është parimi i organizimit kuvendor të pushtetit, gjegjësisht parimi i unitetit në pushtet. Përfaqësuesi i sovranitetit popullor dhe organi suprem i pushtetit në Republikë është Kuvendi Popullor, i cili është bartës i vetëm i pushtetit ligjvënës. Kuvendin Popullor të RPM-së e zgjedhin qytetarët në bazë të të drejtës së përgjithshme, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë me votim të fshehtë për periudhë katërvjeçare.

Kuvendi Popullor, i cili nga viti 1963 është riemërtuar në Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, do të ngelet organi më i lartë deri në pavarësimin e shtetit nga RSFJ-ja në vitin 1991. Parimi i unitetit të pushtetit, përkatësisht sistemi i Kuvendit do të jetë parimi themelor i organizimit të pushtetit në Republikë, ndërsa do të ndryshohet shkalla e shprehjes të tij, përkatësisht, organizimi dhe struktura e Kuvendit (ndryshimet janë përcaktuar në Ligjin kushtetues për bazat e rregullimit shoqëror dhe politik dhe organet e pushtetit të RPM-së e vitit 1952, Kushtetuta e RSM-së e vitit 1963 dhe Kushtetuta e RSM-së e vitit 1974). Në këtë periudhë Kuvendi do të jetë njëdhomësh, dydhomësh, tredhomësh, madje edhe pesëdhomësh. Mandati i përfaqësuesve në Kuvend është imperativ (me mundësi për revokim të përfaqësuesve), ndërsa mënyra e zgjedhjes së tyre ndryshohet nga sistemi i zgjedhjeve të drejtpërdrejta në sistem të ndërlikuar delegues, si sistem i konstituimit të tërthortë të Kuvendit.

20 SHTATOR VITI 1990

Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë miratoi 25 amendamente të Kushtetutës së RSM-së nga viti 1974, duke bërë ndryshime radikale në sistemin shoqëror-ekonomik dhe politik. Kjo e shënon fillimin e tranzicionit të shtetit drejt sistemit të ri parlamentar dhe drejt krijimit të shtetit sovran dhe të pavarur. Me amendamentet kushtetuese mundësohet pluralizëm politik dhe pronësor dhe ristrukturim i institucioneve kryesore të shtetit (Kuvendi bëhet njëdhomësh, Këshilli ekzekutiv bëhet Qeveri, ndërsa në vend të Kryesisë kolektive për herë të parë vendoset funksioni i Kryetarit të Republikës). Sistemi i delegatëve hiqet, ndërsa deputetët në Kuvendin e RSM-së zgjidhen nga qytetarët me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Kandidatët për deputetë i propozojnë qytetarët, organizatat politike dhe format e tjera të organizimit dhe bashkimit. Një muaj më vonë, Kuvendi e miratoi Ligjin për zgjedhje dhe revokim të deputetëve dhe të këshilltarëve, që e paraqet hapin e fundit në përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve të para demokratike dhe shumëpartiake.

11 NËNTOR 1990

Në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë mbajtur zgjedhjet e para të lira demokratike shumëpartiake parlamentare. Zgjedhjet janë zhvilluar sipas modelit zgjedhor të shumicës, ndërsa territori i shtetit është ndarë në 120 njësi zgjedhore. Në këto zgjedhje kanë marrë pjesë 18 parti politike dhe 43 kandidatë të pavarur. Në zgjedhje janë zgjedhur 120 deputetë në Kuvendin e Republikës Socialiste të Maqedonisë. Nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të partive dhe opsioneve të ndryshme politike, në shtet është vendosur sistemi parlamentar me demokraci pluraliste.

8 JANAR 1991

Është konstituuar Kuvendi i parë shumëpartiak i Republikës Socialiste të Maqedonisë, i përbërë nga deputetë të 9 partive politike dhe 3 kandidatë të pavarur. Në pajtim me dispozitat e rregullores së përkohshme, mbledhjen e kryesoi deputeti më i vjetër, ndërsa Kryetar i Kuvendit të Republikës Socialiste të Maqedonisë është zgjedhur Stojan Andovi. Kuvendi i parë shumëpartiak aktivitetet e veta i drejton kah miratimit të akteve dhe dokumenteve të domosdoshme shtetformuese, të cilat e shprehin qartë dëshirën shekullore të popullit tonë për ndërtim të një shteti të pavarur dhe sovran. Pastaj ky Kuvend e zgjodhi Kryetarin e parë dhe Qeverinë e parë të Republikës, shpalli referendum për pavarësinë dhe e miratoi Kushtetutën, himnin dhe flamurin.

25 JANAR 1991

Në njërën nga seancat e para deputetët e kanë miratuar Deklaratën për sovranitetin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, me të cilën shprehet sovraniteti i shtetit në përputhje me përcaktimet kushtetuese për pavarësinë dhe integritetin territorial, si dhe të drejtën e popullit për vetpërcaktim, duke përfshirë edhe të drejtën e shkëputjes. Kjo Deklaratë do të jetë bazë për miratimin e Kushtetutës së parë demokratike disa muaj më vonë.

27 JANAR 1991

Në seancën e Kuvendit si Kryetari i parë i Republikës Socialiste të Maqedonisë është zgjedhur Kiro Gligorovi.

20 MARS 1991

Kuvendi e zgjodhi Qeverinë e parë të Republikës Socialiste të Maqedonisë (e quajtur qeveri eksperte), në krye me dr. Nikolla Kllusevin.

7 QERSHOR 1991

Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë miratoi 4 amendamente të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, duke përfshirë edhe amendamentin për fshirje të atributit "Socialist" para emrit të shtetit.

6 GUSHT 1991

Kuvendi miratoi Vendimin për shpallje të referendumit për deklarimin e qytetarëve për shtet të pavarur dhe sovran. Në këtë Vendim është parashtruar pyetja për të cilën qytetarët do të deklarohen në referendum: "A jeni për shtet të pavarur dhe sovran të Maqedonisë me të drejtë për të hyrë në aleanca të ardhshme të shteteve sovraane të Jugosllavisë?"

8 SHTATOR 1991

U mbajt referendum që qytetarët të shprehen për sovranitetin. Në referendum pozitivisht janë deklaruar 95,09% e qytetarëve që kanë dalë në referendum, ose 72,16% nga numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote. Për këtë arsye 8 shtatori është shpallur festë shtetërore – Dita e pavarësisë.



Ftesa për referendum

17 SHTATORI 1991

Kuvendi miratoi Deklaratën për verifikimin e rezultateve të referendumit lidhur me konstituimin e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Në Deklaratë është theksuar se qytetarët në mënyrë demokratike shënuan faqe të re në historinë shumëshekullore për përfundimin e sovranitetit dhe pavarësisë së shtetit. Deklarata paraqet vendim formal të Kuvendit për konstituim të shtetit të pavarur dhe sovran, duke pasur parasysh faktin se vullneti i qytetarëve i shprehur në referendum nuk kishte karakter vendimmarrës, por vetëm konsultativ.

17 NËNTOR 1991

Kuvendi e shpalli Kushtetutën si aktin më të lartë juridik-shtetëror, me të cilin u përmbyll procesi i gjatë historik i konstituimit shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social i popullit maqedonas. Miratimi i Kushtetutës e shënon fillimin e ndërtimit të rendit të ri kushtetues dhe themelimin shtetit si demokraci parlamentare. Kushtetuta e vitit 1991 është kushtetuta e parë, që e përcakton parimin e ndarjes së pushtetit të shtetit si vlerë themelore e rendit kushtetues (kushtetutat e mëparshme e njihnin parimin e pushtetit të Kuvendit ose parimin e unitetit të pushtetit). Sipas Kushtetutës, pushteti shtetëror ndahet në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Bartës i pushtetit ligjvënës është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është organ përfaqësues njëdhomësh i qytetarëve, i përbërë nga 120 deri në 140 deputetë (numri i saktë i deputetëve është përcaktuar me ligj dhe deri në vitin 2008 ka qenë 120 deputetë, ndërsa pas këtij viti Kuvendi numëron 123, ku tre deputetë zgjidhen nga qytetarët të cilët janë me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit; me ndryshimet e vitit 2015 zgjedhja e këtyre tre deputetëve kushtëzohet me marrjen e një numri të caktuar të votave, që përputhet me numrin minimal të votave të nevojshme për të fituar mandat në njësitë zgjedhore në territorin e shtetit). Deputetët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë për periudhë katërvjeçare. Që nga miratimi i Kushtetutës deri më sot, Kuvendi ka miratuar gjithsej 36 amendamente, që janë pjesë përbërëse e Kushtetutës (në vitin 1992, 1998, 2001, 2003, 2005, 2009, 2011 dhe 2019).



Shpallja e Kushtetutës së vitit 1991 në Kuvend

19 NËNTOR 1991

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Deklaratën për njohje ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Në bazë të kësaj Deklarate, shteti u bë anëtar pothuajse në të gjitha organizatat e rëndësishme ndërkombëtare, me të cilat ka bashkëpunuar në mënyrë aktive dhe me sukses: OKB (1993), OBT (1993), OSBE (1995), Këshilli i Evropës (1995), CEFTA (2006) etj. Vendi është shtet kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (nga viti 2005) dhe në NATO.

14 SHKURT VITI 1992

U miratua Ligji për mbrojtje, sipas të cilit forcat e armatosura (Armata) është përgjegjëse për mbrojtjen e vendit.

26 PRILL 1992

Kuvendi e miratoi Ligjin për njësinë monetare të Republikës së Maqedonisë, me këtë u shpall pavarësia monetare dhe u vendos valuta kombëtare – denari i Maqedonisë.

29 KORRIK 1992

Në këtë datë u miratua Vendimi për anëtarësimin e shtetit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

11 GUSHT 1992

Kuvendi i miratoi flamurin dhe himnin e shtetit.

16 DHE 30 TETOR 1994

U mbajtën zgjedhjet e para parlamentare pas pavarësimit të shtetit. Zgjedhjet u mbajtën njëkohësisht me zgjedhjet e para, të drejtpërdrejta presidenciale, sipas modelit të njëjtë zgjedhor të zbatuar në vitin 1990 (zgjedhjet parlamentare në vitin 1998 u realizuan në përputhje me modelin zgjedhor të kombinuar, ndërsa nga viti 2002 zbatohet modeli proporcional).

16 NËNTOR 2001

Si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit më 13 gusht 2001, janë bërë ndryshime dhe plotësime të rëndësishme të Kushtetutës, si në Preambulë ashtu edhe në një pjesë të madhe të dispozitave në pjesën normative. Zgjidhjet e inkuorpuara në këto amendamente paraqesin ndryshime thelbësore në sistemin kushtetues dhe juridik të shtetit, për të forcuar proceset e integritit të brendshëm të të gjitha bashkësive etnike pa asimilim dhe krijimin e një baze për qëndrueshmëri të vazhdueshme ndëretnike.

11 JANAR 2019

Me miratimin e amendamenteve në Kuvend, emri i shtetit ndryshon në Republika e Maqedonisë së Veriut, emërtimi i Kuvendit ndryshon në Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTJETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përgatitur nga Instituti Parlamentar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për menaxhimin e ndryshimeve (CMP). Përmbytja e publikimit në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SDC.